

Informacion mbi ligjin për qëndrimin në shtëpitë e përkujdesjes

Çfarë është kufizimi i lirisë?

Ashtu di ju, shumë njerëz banojnë në institucione për kujdestari, përkujdesje ose janë pacientë në spitale. Liria e tyre e lëvizjes nganjëherë kufizohet për të penguar rreziqe të tilla si lëndime ose rrëzime. Shembuj për kufizime të tilla të lirisë janë

- Lidhja me rrip në karrigen me rrota ose në krevat
- Pjesë anësore në krevat,
- dyer të kyçura ose edhe
- medikamente, kur ato duhet të ulin dëshirën për të lëvizur.

Kur lejohet kufizimi i lirisë tuaj të lëvizjes?

E drejta themelore për lirinë personale është një prej të drejtave më të rëndësishme të njeriut. Liria juaj lejohet të kufizohet vetëm në kushtet e mëposhtme:

- mangësi intelektuale ose fizike,
- ekziston një rrezik i konsiderueshëm për ju ose njerëz të tjerë,
- nuk ka masa ose alternativa të tjera mbrojtëse. Alternativa janë për shembull krevatë të ulët, dyshekë rrëzimi, tapetë sensori ose kundër rrëshqitjes, trajnim lëvizje ose mjete lëvizëse të duhura.



@ Nina Dietrich



Çfarë të drejtash gëzoni kur kufizohet liria juaj?

- Ju duhet të sqaroheni lidhur me kufizimin e lirisë.
- Kufizimi i lirisë duhet të ndërpritet menjëherë nëse ka mundësi të tjera ose nëse rreziku nuk ekziston më.
- Përveç kësaj, institucioni duhet të dokumentojë me shkrim të gjitha kufizimet e lirisë dhe t'i raportojë te përfaqësimi i banorëve.

Kush është përfaqësimi i banorëve?

Përfaqësimet e banorëve kontrollojnë nëse kufizimet e lirisë janë të nevojshme dhe të arsyeshme.

- Ata flasin me ju, personelin dhe administratën e institucionit.
- Ata lexojnë dokumentacionin e përkujdesjes.
- Ata rregullojnë alternativa për kufizime individuale të lirisë.
- Në rast dyshimi ata paraqesin në kërkesë pranë Gjykatës së Qarkut. Më pas, Gjykata vlerëson nëse kufizimi i lirisë është i lejuar.

Më shumë informacione

www.vertretungsnetz.at

Impressum:

VertretungsNetz – Erwachsenenvertretung, Patientenanwaltschaft, Bewohnervertretung

www.vertretungsnetz.at

Vereinssitz: Wien, ZVR: 409593435